



Pranuar / Dorozuar Priljevoj/Pridato Received/Delivery	08.04.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtjtit Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SMYSHUK	2004/2022		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.219/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.219/2022 të datës 10.03.2022, të parashtruar nga ankuesja**

me adresë Komuna e Prishtinës, kundër organi të punësimit Kuvendi i Republikës së Kosovës, në çështjen juridike “Vlerësim i rezultateve në punë për vitin 2021”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.04.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**HEDHET poshtë si e jashtëafatshme ankesa me numër A.nr.219/2022 e datës 10.03.2022, e parashtruar nga ankuesja**

**A r s y e t i m**

Ankuesja e punësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sipas ndryshim dhe plotësim të Akt emërimit të datës 08.05.2014 në pozitën „Koordinatorë e Njësisë”, në Drejtorinë për Prokurim, me datë 18.01.2022 e ka pranuar nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses respektivisht Drejtori i Drejtorisë për Prokurim, formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, me të cilin ankuesen e vlerësuar me notën e përgjithshme shumë mire 3.80.

Ankuesja me datë 01.02.2022 ja kthen udhëheqësit të saj të drejteperdrejte formularin e vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021 dhe objektivat për vitin 2022 të pa nënshkruar. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses, me datë 01.02.2022 për mes adresës zyrtar (E-mailit) e ka njoftuar Drejtorin e Personelit në Kuvendin e Kosovës se ankuesja pas 10 dite e ka kthyer formularin e vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021 dhe objektivat për vitin 2022 të pa nënshkruara, po ashtu aai njofton se ankuesja nuk ka pranuar të bisedojë për vlerësimin e rezultateve të punës, por edhe nuk ka dhënë komente lidhur me mospajtimin e saj rreth vlerësimit.

Ankuesja e paskanqur me vlerësimin e rezultateve në punës për vitin 2021, me datë 28.02.2022, ka parashtruar ankesë tek Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Personelit në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Drejtori i Drejtorisë për Prokurimi me datë 03.03.2022 i është përgjigjur ankueses në çdo pretendim dhe ka shprehur gatishmëri që të rishikojë vlerësimin me nëpunësen/ankuesen nëse do reflektojë.

E pa kënaqur me përgjigjen e datës 03.03.2022, të Drejtorit të Drejtorisë për Prokurimi ankuesja me datën 10.03.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1284/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.03.2022, e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa më datë 30.03.2022 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 10.03.2022 me numër A.nr.219/2022 me numër protokollit 1284/2022; E-mail i datës 24.02.2022; E-mail i datës 17.12.2021; E-mail i datës 20.08.2021; E-mail i datës 19.08.2021; E-mail i datës 29.07.2021; Tabela e datës 27.12.2021 për punët e ndara nga Drejtoria e Prokurimit; Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2021, me E-mail të datës 07.07.2021 dhe i datës 16.07.2021; E-mail i datës 07.07.2021-Vërejtje me gojë; E-mail i datës 07.07.2021-kërkesë për sqarim, renovimi i ndërtesës; E-mail i datës 28.07.2020-Interpretim i KRPP-së; E-mail i datës 28.07.2020 Kërkesë për interpretim ligjor; E-mail i datës 22.09.2021 Njoftim; E-mail i datës 27.09.2021 refuzim i punës dhe të datës 23.09.2021, bashkangjitur kopje nga kompjuteri- procedurat e shfrytëzuesve; Përgjigje e datës 30.03.2022; E-mail i datës 30.12.2021; Ndryshim dhe protësim i akte emërimit nr.25/14 i datës 08.05.2014, me detyra të punës; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punës të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtuese dhe profesionale-objektivat për 2022, i datës 18.01.2022; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punës të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtuese dhe profesionale-objektivat për 2021, i datës 18.01.2021 me të dhënat e përgjithshme, i datës 18.01.2022; E-mail i datës 01.02.2022; Plani i punës i datës 31.12.2019; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punës të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtuese dhe profesionale-objektivat për 2020, i datës 22.01.2021; kopje shkresa lidhur me komentet e vlerësimin, i datës 11.02.2021; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punës të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtuese dhe profesionale-objektivat për 2019, i datës 31.12.2019; E-mail i datës 28.02.2022; Ankesë e datës 28.02.2022, lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, për Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit të Kosovës; E-mail i datës 24.02.2022; E-mail i datës 29.07.2021- kërkesë për pushim vjetor; E-mail datës 29.07.2021 përgjigje sipas kërkesës për pushim; E-mail datës 25.01.2022-dalja nga vendi i punës pa leje; E-mail i datës 25.01.2022-kërkesë; E-mail i datës 25.01.2022 -shqiptim i masës "vërejtje"; E-mail i datës 24.01.2022-sqarim; E-mail i datës 03.03.2022 bashkangjitur kopje e shkresës zyrtare sipas ankesës së datës 28.02.2022; E-mail i datës 01.02.2022; E-mail i datës 19.08.2021 bashkangjitur fleta e të dhënave të tenderit(FTD) prej 1/3 faqe; Kërkesë për avancim dhe plotësim i vendeve të lira në Drejtorinë e prokurimit-Njësia e Prokurimit e datës 25.01.2022; E-mail i datës 10.02.2022 për sqarim të tenderimit; E-mail i datës 28.10.2021 Njoftim për vendimin e AK; E-mail i datës 31.08.2021 Raport i vlerësimin të tenderëve me provat e bashkangjitura nga sistemi 1/3 faqe; E-mail i datës 01.10.2021 kërkesë; E-mail i datës 29.07.2021; Formular i kërkesës për pushim vjetor i datës 27.05.2021; Formular i kërkesës për pushim vjetor i datës 21.06.2021; E-mail i datës 29.07.2021 Procedurë e re - sigurim i transportit; E-mail i datës 31.07.2021 Për procedurë; E-mail i datës 29.07.2021 procedurë e re -furnizimi me lule; kopje në formë tabelore të prokurimit 2021; E-mail i datës 02.07.2020 Mospajtim; E-mail i datës 02.07.2020 kërkesë për shtyrjen e procedurave; E-mail i datës 02.07.2020 nënshkrim i kontratës; E-mail i datës 07.07.2020 Sqarim; E-mail i 11.05.2021 kërkesë për dorëzim me shkrim të raportit mujor të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankueses

*është e jashtëafatshme sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht ndryshimit dhe plotësimit të Akt emërimit të datës 08.05.2014 rezulton se ankuesja \_\_\_\_\_ është e punësuar në pozitën e punës „Koordinatorë e Njesisë”, në Drejtorinë për Prokurim, në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Drejtori i Drejtorisë për Prokurim në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë, me datën 18.01.2022, ka bërë vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021, për ankueser \_\_\_\_\_ me c' rast të njëjtën e ka vlerësuar me notë të përgjithshme shume mirë (3.80).

Ankuesja \_\_\_\_\_ me datë 18.01.2022 e ka pranuar formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021 nga mbikeqyresi i saj i drjtepperdrejte.

Ankuesja e pakënaqur me vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021 të pranuar me datë 18.01.2021 nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i saj, me datë 28.02.2022, ka parashtruar ankesë tek Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Personelit në Kuvendin e Republikës së Kosovës kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021. Mbikeqyresi i saj i drjtepperdrejte, respektivisht me datë 03.03.2022 i është përgjigjur ankueses në çdo pretendim dhe ka shprehur gatishmëri që të rishikojë vlerësimin me nëpunësen/ankuesen, mirepo ankuesja e pa kënaqur me përgjigjen e datës 03.03.2022, të Drejtorit të Drejtorisë për Prokurim me datës 10.03.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1284/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, ndërsa Ligji Nr.05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 përcakton se: ***“1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.***

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, respektivisht formularin e vlerësimit të rezultateve të punës të datës 18.01.2021, të dorëzuar nga organi i punësimit, tek ankuesja ka konstatuar se ushtrimi i ankesës me datën 10.03.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 13 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publikë, ku përcaktohet se: ***1. Nëse nëpunësi civil nuk pajtohet me vlerësimin përfundimtar të mbikëqyrësit, ka të drejtë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil. 2. Ndërsa nëpunësi i shërbimit publik ka të drejtë ankesë në Komisionin e ankesave të institucionit. 3. Afati për ushtrimin e ankesës së në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni është tridhjetë (30) ditë nga dita e marrjes së formularit të vlerësimit nga nëpunësi.*** Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vlerësuar se ankuesja \_\_\_\_\_ nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimit brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës respektivisht nga data 18.01.2021 kur ankuesja e ka pranuar formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021 nga mbikeqyresi i saj i drjtepperdrejte.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.219/2022.**

Zyle Mihaliku **GOJNOVCI**

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses
- Sekretarit Përgjithshëm në Kuvendin e Kosovës,
- Udhëheqësit të Personelit në Kuvendin e Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

